



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

STRUKTURA DHE KRITERET E REALIZIMIT TË MIKROTEZËS
PËR DIPLOMIM NË PROGRAMIN:
BACHELOR / MASTER _____

1. Struktura e punimit shkencor

Punimi shkencor duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:

- **Abstrakti**
- **Mirënjohja**
- **Tabela e përmbajtjes**
- **Studimi**
 - Hyrja
 - Lista e tabelave, diagrameve, shtojcave
 - Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes
 - Metodologjia
 - Rezultatet e studimit
 - Diskutimi
 - Përfundime dhe propozime
 - Bibliografia
 - Shtojca

1.1 Abstrakti

Çdo punim duhet të përmbajë një abstrakt. Abstrakti duhet të jetë një përmbledhje që paraqet pikat kryesore dhe përfundimet e punimit. Abstrakti duhet të vendoset para falenderimeve dhe tabelës së përmbajtjes. Abstrakti nuk duhet t'i kalojë 350 fjalët.

1.2 Mirënjohja

Duhet paraqitur mirënjohja për të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e punimit dhe financimin e tij.

1.3 Tabela e përmbajtjes

Në këtë seksion paraqitet tabela e përmbajtjes me elementet e strukturës së punimit, titujt përkatës dhe numrin e faqeve për secilin element.

1.4 Studimi

Studimi, përgjithësisht, duhet të ketë këtë format:

1.4.1. Hyrja. Seksioni i hyrjes duhet të prezantojë fushën e studimit, çështjen e marrë në studim, detyrën shkencore, të përmbledhë informacionin e rëndësishëm dhe strukturën e punimit.

1.4.2. Lista e tabelave;

Lista e ilustrimeve (*figurave*);

Lista e shtojcave. Në këtë seksion paraqiten vetëm listat e tabelave, ilustrimeve, shtojcave të përdorura në punim. Ky seksion përfshihet nëse tema jep mundësi për përdorimin e tabelave, ilustrimeve, shtojcave.

1.4.3. Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes. Në këtë pjesë paraqiten kontributet e studiuesve të ndryshëm për çështjen e marrë në studim.

1.4.4. Metodologjia. Në këtë seksion prezantohen detajet e metodologjisë së kërkimit, mënyrat, mjetet dhe materialet e përdorura.

1.4.5. Rezultatet e studimit. Kjo pjesë përmban rezultatet e studimit. Rezultatet paraqiten në trajtën e të dhënave statistikore dhe të përshkrimeve cilësore.

1.4.6. Diskutimi. Ky seksion përmban krahasimin e rezultateve, me pika të caktuara referimi dhe interpretimin e rezultateve. Rezultatet e analizës së të dhënave krahasohen me rezultatet e përfuara nga studiuesit e tjerë ose të diskutuara në kontekstin e hipotezave. Gjithashtu, në këtë pjesë paraqitet kritika për çështjen e marrë në studim dhe bëhen komente.

1.4.7. Përfundime. Ky seksion përmbledh gjetjet kryesore të studimit.

1.4.8. Propozime të tjera. Ky seksion nuk është i detyrueshëm dhe kërkohet vetëm nëse rezultatet justifikojnë kërkimin e mëtejshëm.

1.4.9. Bibliografia. Të gjitha punimet shkencore duhet të përdorin literaturën dhe të tregojnë burimin për citatat që përdorin. Seksioni i bibliografisë duhet të vendoset në faqe më vete.

1.4.10. Shtojcat. Ky seksion përmban ilustrime shtesë, të dhëna e shifra origjinale që janë shumë të gjata për t'u përfshirë në tekst. Ato përfshihen në "Shtojca", në mënyrë që të mos e shkëpusin lexuesin nga diskutimet origjinale. Shtojcat mund të ndahen në seksione. Secila shtojcë ka titullin e vet dhe mund edhe të paraqitet veçmas në faqen e *Tabelës së Përmbajtjes*.

Në këtë rubrikë përfshihen materiale të tilla plotësuese si: instrumente të ndryshme të kërkimit, të përdorura në studim, pyetësorë, intervista, harta, dokumente ligjore, historike, seri fotografish etj.

Të gjithë kapitujt, çështjet, rubrikat e studimit renditen me rend numerik.

2. Kërkesa teknike për punimin shkencor

2.1. Formatit

Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet, deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

2.2. Lidhja

Tre kopje të punimit shkencor duhet të lidhen si libër. Njëra prej kopjeve duhet të jetë origjinalja. Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit, i departamentit, i masterit, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes. Sfondi i kopertinës së punimit duhet të jetë me ngjyrë blu dhe shkronjat me ngjyrë të verdhë. Shih modelin e bashkangjitur në këtë paketë. (faqe 8 & 9)

Pjesa e pasme e kopertinës e cila duhet të jete po me ngjyrë blu dhe shkronjat me ngjyrë të verdhë duhet të përmbajë:

- Abstraktin në shqip dhe në anglisht. Secili variant duhet të përmbajë 250 fjalë. Përdoret madhësia 10-she e shkronjave. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar subjekti në të. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.
- Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disipinën përkatëse. Ato ndihmojnë për identifikimin e tezës në katalogët kolektivë në biblioteka.

Shih formatin e pjesës së pasme të kopertinës bashkangjitur në këtë paketë.

2.3. Gjatësia e punimit

Pjesa e studimit shkencor për diplomën

- Bachelor “Drejtësi” duhet të ketë si rregull jo më pak se 20 dhe jo më shumë se 40 faqe të formatit A4,
- Master Profesional “Shkenca Administrative” duhet të ketë si rregull jo më pak se 30 faqe të formatit A4
- Master Shkencor “Marrëdhënie Ndërkombëtare” jo më pak se 50 të formatit A4,

të shkruara me kompjuter. Referencat, shënimet në fund të faqes, shtojcat, tabelat dhe diagramet nuk përfshihen në këtë përllogaritje.

Vendi që zënë elementet e punimit:

- Hyrja 10 %
- Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes 20%
- Metodologjia – 15 %
- Rezultatet e studimit 20%
- Diskutimi – 20%
- Përfundime -10%
- Bibliografia – 5%

Për të llogaritur kufirin e fjalëve dhe të faqeve rekomandohet metoda e mëposhtme e llogaritjes:

- për çdo faqe të mikrotezës nuk do të përdoren më shumë se 2310 karaktere;
- numri i karaktereve përllogaritet, duke përfshirë hapësirën dhe pikësimin në një radhë dhe më pas shumëzohen me numrin e radhëve;
- në një radhë duhet të jenë 70 karaktere, ndërsa në një faqe një maksimum prej 33 radhësh.

2.4. Lloji i letrës

Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.

2.5. Shtypja

Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës.

Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.

2.6. Cilësia e shtypjes

Teksti duhet të shtypet me hapësirë një e gjysmë ndërmjet radhëve (1.5). Hapësira njëshe do të përdoret për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë.

Duhet përdorur vetëm një lloj shkrimi. Lloji i shkrimit duhet të jetë **Times New Roman**. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she, me justify.

3.7. Margjinat

Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:

- margjina e sipërme: 2,5 cm;
- margjina e poshtme: 2,5 cm;
- margjina e majtë: 2,5 cm;
- margjina e djathtë: 2,5 cm

3.8. Numrat e faqeve

Të gjithë numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.

Hyrja duhet të ketë numra romakë.

Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.

Faqet e bibliografisë dhe shtojcave duhet të numërohen me numra arabë, duke vijuar sipas numrave të tekstit.

3.9. Shënimet

Në shkencat sociale dhe humane përdoren gjerësisht shënimet. Studentët këshillohen të përdorin referenca të botimeve të ndryshme të fushës, të raporteve ose të disertacioneve të kandidatëve të suksesshëm, të cilat mund të gjenden në biblioteka.

Madhësia e shkronjave të shënimeve është më e vogël se ajo e tekstit. Shënimet në fund ta faqes, si dhe të gjitha llojet e tjera të shënimeve, duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she.

2.10. Tabelat

Tabelat është mirë të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numri i tabelës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket.

Fjala “tabelë”, numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër, legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate, referencat duhet të theksohen.

2.11. Diagramet

Nëse diagramet paraqiten si fotografi, duhet të vendosen në faqen përkatëse; ilustrimet ose grafikët jo gjithmonë e ndjekin tekstin ose tabelën. Fjala “figurë”, numri i diagramit me shifër

arabe dhe shpjegimet duhet të vendosen poshtë diagramit. Përgjithësisht, një diagram nuk duhet ta kalojë një faqe. Nëse diagrami vazhdon në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli për tabelat. Si edhe tabelat, diagramet duhet të mbledhen bashkë dhe t'u vihen numra ndjekës. Fotografitë që janë më të vogla se një faqe duhet të vendosen në faqen përkatëse.

2.12. Materialet shoqëruese

Nëse një punim përmban materiale shoqëruese, të tilla si: disketa kompjuteri, CD, DVD, kasetta video, etj., që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t'i bashkëngjiten punimit.

2.13. Referencat

Punimi do të shoqërohet patjetër me shënime në fund të faqes (footnotes) ose në fund të tekstit (endnotes). Por referencat janë të detyrueshme.

Sistemi i referencave është bazuar në sistemin e Harvardit, me referenca të vendosura përgjatë tekstit të mikrotezës dhe të listuara në fund të tij, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve. Ato duhet të përbëjnë pesë elemente, që janë:

a. Referencat e librave:

1. autori/ose autorët; 2. viti i botimit; 3. titulli i librit (në kursiv); 4. qyteti/vendi ku është botuar; 5. botuesi.

Për shembull:

1. Me një autor:

Smith, F. (1978). *Reading*. Cambridge: Cambridge University Press.

2. Me dy autorë:

Fromkin, V. & Rodman, R. (1983). *An introduction to language*. London: Holt-Saunders.

3. Me shumë se me dy autorë:

Steiner, H.J., & Alston, P., & Goodman, R. (2007). *International Human Right in context*. UK: Oxford.

b. Referencat e artikujve nga revistat shkencore, ose përmbledhjet:

1. autori/autorët; 2. viti i botimit; 3. titulli i artikullit (në thonjëza); 4. titulli i revistës/përmbledhjes ku është botuar (në kursiv); 5. vëllimi, numri dhe faqet.

Për shembull:

Bruce, Haddock. 2010. "Demokracia, stabiliteti dhe Europa: Tranzicioni në një kontekst më të gjerë", *Gjeopolitika*, Vëll. 2, Nr. 4, fq. 32-38.

c. Referenca të dokumenteve të marra nga www.

Për shembull:

Department of Industry, Tourism and Resources 2006, *Being Prepared for an Influenza Pandemic: a Kit for Small Businesses*, Government of Australia, Marrë nga: <<http://www.innovation.gov.au>>. [28 Shkurt 2009].

d. Referencat e shkurtuara brenda tekstit

Për shembull:

Për një autor: Smith (1978); (Smith, 1978: 156); ose Smith (1978: 156);

Për dy autorë: (Kadare & Bosquet, 1990).

Për tre autorë: (Kadare, Simic & Frkoski, 2001).

Në të njëjtën mënyrë edhe për referencat e tjera.

3. Etika e kërkimit

3.1. Studimi duhet të jenë punë origjinale e kandidatit.

3.2. Një kandidat nuk lejohet të paraqesë si punim për diplomën master një punim që e ka paraqitur për një gradë tjetër në këtë universitet ose në një universitet tjetër, por kandidati nuk ndalohet të përfshijë pjesë të punës, nëse ai tregon qartë cila pjesë e punës është përdorur më parë.

3.3. Një kandidat mund të paraqesë një pjesë kontributi që është botuar më parë individualisht ose në grup. Nëse puna është pjesë e përpjekjeve të një grupi, një shpjegim për pjesën e shkruar nga kandidati duhet të përfshihet në punim.

3.4. Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit shkencor, me lejen e udhëheqësit kandidati mund të botojë pjesë të studimit shkencor.

3.5. Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër, pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse, nëse përdoren idetë e të tjerëve.

3.6. Përdorimi i ideve ose i punës së të tjerëve duhet të evidencohet individualisht në tekst ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.

3.7. Të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe t'u shënohet burimi.

3.8. Nëse pasazhet e marra nga të tjerët janë më të gjata se pesë radhë nuk futen në thonjëza, por shënohet referenca për to.

3.9. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore.

3.10. Nëse burimi origjinal nuk gjendet dot, por burimi është përmendur në një dokument tjetër, atëherë të dy dokumentet, burimi origjinal dhe burimi dytësor duhet të jepen.

3.11. Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por përkundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme. Pandershmëria akademike e cila përfshin deklarime false, të dhëna të rreme, prezantimi i punës së grupit si punë individuale dhe plagjiatura i duhen shpjeguar studentit. Megjithatë, rastet e mosrespektimit të rregullave të citimeve për shkak të pakujdesisë ose të mosdijes do të dallohen nga ato ku pandershmëria është e dukshme dhe e qartë.

3.12. Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur drejtorit të institutit, për veprime të mëtejshme.

3.13. Pronësia intelektuale. E drejta e autorit për punimin (*si edhe për një material të botuar*) mbrohet nga ligji ndërkombëtar i së drejtës së autorit. Shënimi për rezervimin e të drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë dhe viti i punimit duhet të vendosen në faqen që vjen pas titullit të punimit.



UNIVERSITETI I VLORËS
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

BACHELOR / MASTER NË _____

TEMË DIPLOME

(Titulli i temës)

DIPLOMANTI

UDHËHEQËSI SHKENCOR

(Titulli i udhëheqësit) _____

VLORË, MUAJI, VITI .

ABSTRAKT (shqip)

TITULLI (anglisht)

FUSHA E STUDIMIT (shqip dhe anglisht)

FJALËT KYÇE (shqip dhe anglisht)